



Datë/a:	18.02.2021
Referenc-ë:	07-353/04-30532/21
Për/ Za/ To:	- Bashkësia Islame e Kosovës Kryetari Myftiu Naim ef. Tërnavë - Fondacioni “Ejup Sulltan”- Stamboll
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim ka pranuar kërkesën 07-353/04-30532/21 nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) në Prishtinë të cilën e përfaqëson Kryetari Myftiu Naim ef. Tërnavë, për shfrytëzimin e hapësirës publike mbi Pllaton e Pallatit të Rinisë.

Qëllimi i shfrytëzimit të hapësirës publike është vendosja e tendës për përgatitjen e ushqimit për Iftar gjatë muajit të Ramazanit gratis për mysafir, nga data 13 Prill deri me 12 Maj 2021.

Ky aktivitet për organizimin e iftareve gjatë muajit të Ramazanit është duke u mbajtur që disa vite në bashkëpunim dhe financim nga Fondacioni “Ejup Sulltan” nga Stambolli dhe BIK-ut.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep **pëlqimin** BIK-ut në bashkëpunim me Fondacionin “Ejup Sulltan” nga Stambolli, për shfrytëzimin e hapësirës publike në Pllaton e Pallatit të Rinisë. Aktiviteti përfshin vendosjen e tendës në Pllaton e Pallatit të Rinisë, tavolinat për ushqim dhe pajisjet e kuzhinës për përgatitjen e ushqimit.

Organizatori obligohet që:

- të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK);
- përgatitja e ushqimit dhe servimi për mysafir të bëhet në kushte higjieniko-sanitare.
- pas përfundimit të aktivitetit të largohet shtandi me pajisje dhe të pastrohet hapësira, të mos mbesin mbeturina;
- të kujdesen për mirëmbajtjen e hapësirës së lejuar për shfrytëzim;
- të mos shkaktohen dëmtime gjatë montimit apo demontimit të tendës;

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar. Në rast se shtohen masat e kufizimit nga IKSHPK, drejtoria ka të drejtën e revokimit të pëlqimit.

1000

